

RELACION SHPJEGUES

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KUJDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”, propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), si një akt politik dhe social i qeverisë shqiptare, që synon garantimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë, duke siguruar vendosjen e tyre në një mjedis familjar të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Projektligji hartohet në vijim të politikave për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijës dhe synon rregullimin e çështjeve themelore të kujdesit alternativ në familje, duke garantuar të drejtën e fëmijëve pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë, për një mjedis familjar të sigurt, të qëndrueshëm dhe mbështetës. Ky projektligj synon ofrimin e mundësive të barabarta për zhvillim, përfshirje dhe mirëqenie të fëmijëve, përmes vendosjes së standardeve të qarta, procedurave dhe mekanizmave të mbrojtjes në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Projektligji synon zbatimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuar për Kujdesin Alternativ si dhe të Udhëzimeve të Bashkimit Evropian, për të ndihmuar vendet e BE-së në procesin e transformimit të institucioneve rezidenciale në shërbime komunitare me bazë familjen dhe zhvillimin e një game të shërbimeve me bazë komunitare, për të eliminuar nevojën për kujdes rezidencial.

Projektligji kontribuon në përmbushjen e piketave të ndërmjetme në kuadër të procesit negociues të Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, veçanërisht në fushën e garantimit të të drejtave të fëmijës, forcimit të mekanizmave administrative për mbrojtjen e tyre, si dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet e Bashkimit Evropian dhe instrumentet ndërkombëtare për kujdesin alternativ, në funksion të përparimit të procesit të integritetit evropian të vendit dhe forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Në mbështetje të synimit të përgjithshëm, qëllimet kryesore të këtij ligji janë:

- organizimi dhe ofrimi i shërbimit të kujdesit alternativ në një mjedis të përshtatshëm familjar për fëmijët në nevojë për përkujdes dhe mbrojtje, në rrezik të mos pasjes së kujdesit prindëror, ose pa kujdes prindëror, me qëllim ruajtjen dhe garantimin e zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës.
- organizimi dhe ofrimi i shërbimit të kujdesit alternativ në familje, sipas nevojave individuale dhe në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të gjithanshëm të fëmijës në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe përfshirës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së RSH.

Projektligji është në përputhje me vizionin e Qeverisë shqiptare dhe në përmbushje të prioritetëve të shpallura në Programin Politik Qeverisë 2025-2029, i cili identifikon familjen dhe fëmijët si përparësi të politikave sociale, duke iu referuar tri shtyllave kryesore të programit qeverisës dhe objektivat përkatëse: Shtylla III: Mirëqenie për të gjithë, thekson se mirëqenia shihet si e drejtë për çdo shqiptar. Vizioni i Shqipërisë 2030 përcaktohet si një vend me fytyrë njerëzore dhe institucione që punojnë për qytetarin. Pika 3.3. e kësaj shtylle, “Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi” të programit qeverisës synon një sistem social gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm, ku familja është në qendër dhe ku mbrohen më të brishtët. Projektligji e bën këtë konkrete duke zhvendosur fokusin nga institucionalizimi tek kujdesi në mjedis familjar, duke e trajtuar fëmijën si subjekt të të drejtave dhe duke garantuar interesin më të lartë të fëmijës në çdo vendim.

Pika 3.3 thekson shtrirjen territoriale të shërbimeve, ndërkohë që projektligji i ngarkon pushtetit vendor rolin kyç në këtë proces. Po ashtu, në këtë pikë flitet për rritje të shpenzimeve sociale për grupet vulnerabël, ndërsa projektligji krijon bazën ligjore të financimit për fëmijët në kujdes alternativ, pagesë të pagave dhe sigurimeve shoqërore për familjet që ofrojnë shërbim të kujdesit alternativ profesional, si dhe metodologji për masën e financimit sipas moshës/nevojave të fëmijës. Kjo bën të mundur targetimin efikas të fondeve. Po ashtu, në Program parashikohet fuqizimi i rrjetit komunitar dhe bashkëpunimin me bashkitë. Projektligji formalizon rolin e OJF-ve të licencuara në trajnim, mbështetje gjatë/pas kujdesit alternativ dhe rritjen e kapaciteteve të bashkive për kujdesin alternativ.

Programi qeverisës parasheh rritjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve dhe përmirësimin e shërbimeve sociale për familjet në nevojë. Prioritetet e programuara në projektligj, forcimi i kujdesit për fëmijët, mbështetja e familjeve pa përkujdesje prindërore dhe zgjerimi i shërbimeve sociale, janë në përputhje me programin Qeverisë 2025–2029.

Ky projektligj lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 dhe me strategji të tjera ndërsektoriale dhe plane veprimi. Ai synon sigurimin e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 152, datë 13.3.2024, e cila përcakton zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të shërbimeve për fëmijët pa kujdes prindëror, duke promovuar kujdestarinë alternative si një formë prioritare të mbrojtjes së fëmijës dhe si mjet për reduktimin e institucionalizimit, Gjithashtu, projektligji është në përputhje me vizionin e strategjisë - kujdes social për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze, në një mjedis mundësues dhe fuqizues, përgjatë ciklit të jetës.

Projektligji përmbush detyrimet e parashikuara në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, miratuar me VKM Nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026”, e cila është hartuar duke pasur parasysh edhe Strategjinë e Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijëve 2022–2027. Konkretisht masa II.2.1.a parashikon Hartimin dhe miratimin e ligjit, “Për kujdesin alternativ”, në kuadër të përmirësimit të kornizës ligjore në sistemin e mbrojtjes, kujdesit të fëmijëve dhe sistemit të drejtësisë”

Projektligji pasyron angazhimet sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), në fuqi që prej 2009. Neni 80 i MSA-së (për bashkëpunimin në politikën sociale) inkurajon zhvillimin e

politikave sociale dhe shëndetësore, me vëmendje të veçantë për mbrojtjen e grupeve vulnerabël si fëmijët. Gjithashtu, progres-raportet e BE-së dhe planet kombëtare të zbatimit të MSA kanë nënvizuar rëndësinë e forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri si pjesë e procesit integrues.

Në kuadër të Kapitullit 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”, pjesë e Grupkapitullit III të proceseve negociuese për integrimin evropian, kërkohej përmirësime në politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, përfshirë forcimi i mbrojtjes së fëmijëve sipas standardeve të BE-së dhe zhvillimi i një sistemi gjithëpërfshirës shërbimesh sociale.

Këshilli i Ministrave ka miratuar me Vendim Nr. 736, datë 13.12.2023 Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës (Grupkapitulli I “Themeloret”), i cili nënvizon angazhimin e shtetit shqiptar për garantimin e të drejtave themelore të fëmijëve, mbrojtjen e tyre nga dhuna, dhe sigurimin e një sistemi të fortë social e institucional që promovon interesin më të lartë të fëmijës. Në seksionin e të drejtave themelore të këtij Udhërrëfyesi përfshihen edhe angazhimet specifike për të drejtat e fëmijëve. Këto qëllime konfirmohen nga masat konkrete të parashikuara në udhërrëfyes:

- Garantimi i të drejtës për rritje në familje dhe deinstitutionalizimi: Udhërrëfyesi parashikon finalizimin e de-institutionalizimit të fëmijëve pa kujdes prindëror, duke u siguruar që fëmijët të kalojnë nga institucionet drejt mjediseve familjare dhe komunitare. Masat e përcaktuara synojnë mirëqenien dhe tranzicionin e suksesshëm të fëmijëve drejt kujdesit familjar, si dhe zgjerimin e shërbimeve alternative në komunitet. Ky është një hap i rëndësishëm drejt garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, që është të rritet në një mjedis sa më pranë një familjeje.
- Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve: Një prioritet tjetër i udhërrëfyesit është forcimi i mbrojtjes së fëmijëve nga çdo formë dhune. Dokumenti përfshin masa për uljen e rasteve të dhunës dhe abuzimit, përmirësimin e politikave të sigurisë (p.sh. kundër abuzimit seksual online) dhe forcimin e kapaciteteve të Policisë e institucioneve të drejtësisë për të reaguar ndaj dhunës ndaj fëmijëve. Kjo tregon qartë se shteti shqiptar ka theksuar në këtë udhërrëfyes detyrimin për të mbrojtur fëmijët nga dhuna, si pjesë e reformave themelore të integritetit.
- Fuqizimi i sistemit institucional të mbrojtjes së fëmijëve: Udhërrëfyesi parashikon masa për forcimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, si p.sh. rritjen e numrit të njësive të mbrojtjes së fëmijëve dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve lokale, shëndetësore, arsimore dhe OJF-ve, për të siguruar një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse në mbrojtjen e fëmijëve.

Projektligji është në harmoni me Planin Kombëtar të Deinstitutionalizmit të kujdesit për fëmijët, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 26.09.2025 nga Komiteti Drejtues për Deinstitutionalizmit, i cili parashikon ndërtimin e një sistemi të përkujdesjes sociale të integruar funksionale dhe gjithëpërfshirëse, transformimin e përkujdesit rezidenciale në kujdes alternative.

Projektligji/ parimet udhëheqëse të tij janë hartuar në përputhje të plotë me Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ për Fëmijët (Guidelines for the Alternative Care of Children, 2009). Po ashtu, llojet e kujdesit alternativ në familje, apo rregullat e ofrimit të shërbimit, ndërgjegjësimi, monitorimi, raportimi, procedurat e ankimit janë në përputhje të plotë me këtë Udhëzues.

Projektligji pasqyron edhe lidhjen e drejtpërdrejtë me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm e) Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ). Në mënyrë specifike lidhet sidomos me disa prej objektivave të Axhendës 2030 të OKB, si vijon:

- OZHQ 1, Zhdukja e varfërisë: Projektligji synon mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe mbështetjen e familjeve vulnerabël, gjë që ndihmon në thyerjen e ciklit të varfërisë për këto kategori. Garantimi i një familjeje alternative dhe i shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë kontribuon drejtpërdrejt në reduktimin e varfërisë së fëmijëve;
- OZHQ 3, Shëndet i mirë dhe mirëqenie: Sigurimi i kujdesit alternativ cilësor (foster care, kujdestari, etj.) nënkupton që fëmijët pa prindër do të kenë një mjedis më të shëndetshëm familjar dhe akses më të mirë në shërbime shëndetësore e psikologjike. Kjo përmirëson mirëqenien e tyre fizike dhe mendore, duke kontribuar në OZHQ 3;
- OZHQ 4, Arsimit cilësor: Një fëmijë që rritet në një ambient familjar të qëndrueshëm ka mundësi më të mira për të ndjekur arsimin. Projektligji, duke synuar integrimin familjar dhe mos-institucionalizimin afatgjatë, ndihmon që këta fëmijë të mos mbeten pas në arsim. Kjo lidhet me objektivin për arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë;
- OZHQ 5, Barazi gjinore: Ndër përfituesit e ligjit pritet të jenë edhe vajzat e djemtë e braktisur apo në nevojë. Kujdesi alternativ i mirë strukturuar garanton që si vajzat ashtu edhe djemtë të kenë mbrojtje të barabartë. Po ashtu, mbështetja e familjeve vulnerabël (shpesh nënat kryefamiljare) kontribuon në fuqizimin e grave dhe vajzave në shoqëri;
- OZHQ 10 – Ulja e pabarazive: Ligji synon të mbrojë fëmijët më të cënueshëm – një kategori shpesh e marginalizuar dhe t’u sigurojë atyre mundësi të barabarta në jetë. Kjo është thelbësore për uljen e pabarazive sociale. Nëpërmjet kujdesit alternativ gjithëpërfshirës dhe shërbimeve sociale, diferencat midis këtyre fëmijëve dhe moshatarëve të tyre zvogëlohen;
- OZHQ 11, Qytete dhe komunitete të qëndrueshme: Zhvillimi i shërbimeve sociale të integruara në komunitet për fëmijët pa kujdes prindëror do të thotë komunitete më gjithëpërfshirëse dhe më të qëndrueshme. Kur çdo bashki ofron shërbime për fëmijët në nevojë, komuniteti bëhet më i fortë dhe më solidar; Gjithashtu, promovimi i kujdesit në familje (p.sh. familjet kujdestare) krijon një mjedis komunitar më human dhe të qëndrueshëm.
- OZHQ 16, Paqe, drejtësi dhe institucione të forta: Ky objektivi lidhet me ndërtimin e institucioneve të forta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ligji për kujdesin alternativ forcon kuadrin ligjor (pra institucionet dhe politikat) për mbrojtjen e fëmijëve, një aspekt kyç i drejtësisë shoqërore. Gjithashtu, duke mbrojtur fëmijët nga abuzimi e neglizhenca, kontribuohet në një shoqëri më paqësore dhe në respektimin e së drejtës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi dhe zbatimi i këtij projektligji synon të sjellë:

- Shërbime më cilësore dhe më të qëndrueshme për fëmijët;
- Mbështetje më të mirë për aktorët lokalë dhe qendrorë;
- Trajtim të barabartë për çdo fëmijë, pavarësisht situatës së tij/saj;
- Forcim të sistemeve për monitorim dhe raportim;

- Sigurimin e një tranzicioni të suksesshëm për fëmijët që dalin nga kujdesi.

Bazuar në sa më sipër, miratimi i projektligjit është i qenësishëm.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar.

Projektligji është në harmoni të plotë dhe plotëson kuadrin ligjor në fuqi për përdjesin dhe mbrojtjen për fëmijët, si:

- Kodi i familjes, ligji nr. 9062 datë 08.05.2003, i ndryshuar;
- Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nr. 18/2017;
- Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror, nr. 121/2016;
- Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, nr. 8153 datë 18.12.2006,i ndryshuar;
- Ligji për procedurat e birësimit dhe Komitetin shqiptar të birësimit, nr. 9695 datë 19.03.2007, i ndryshuar.

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji i hartuar në këtë fazë ka përputhshmëri të plotë me udhëzimet e BE-së për kujdesin alternativ. Edhe pse nuk ka një *acquis* të drejtpërdrejtë që të lidhet me kujdesin alternativ në familje, ai respekton udhëzuesin e OKB-së për kujdesin alternativ si dhe komunikimet e BE-së të cilat kërkojnë që kujdesi alternativ të trajtohet me kujdesin e nevojshëm. Projektligji është në harmoni me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, posaçërisht me nenin 24, Të drejtat e fëmijës, i cili parashikon se fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje dhe kujdes të nevojshëm për mirëqenien e tyre, të shprehin lirisht pikëpamjet e tyre, se interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë konsiderata parësore në çdo vendimmarrje për to, dhe se çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë rregullisht një marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit e tij ose të saj, përveç nëse kjo është në kundërshtim me interesat e tij ose të saj.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj krijon një kuadër të plotë ligjor për kujdesin alternativ në familje për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për ta humbur atë. Ai e vendos theksin tek siguri i një mjedisi sa më të afërt me jetën familjare, duke synuar zhvillimin e gjithanshëm, të sigurt dhe të qëndrueshëm të fëmijës, gjithmonë në përputhje me parimin e interesit më të lartë të tij. Për herë të parë miratohet një ligj i dedikuar vetëm kujdestarisë familjare si formë përkujdesi alternativ, i ndarë nga institucionet rezidenciale dhe format e tjera të përkujdesjes. Ky projektligj është një qasje bashkëkohore për ofrimin e një mjedisi sa më të sigurt dhe familjar në çdo rast për fëmijët në përputhje me parimin e interesit më të lartë të tyre.

Projektligji përcakton llojet e kujdesit alternativ në familje: kujdesin vullnetar, që ofrohet nga të afërm të fëmijës dhe familje që nuk kanë lidhje familjare me fëmijën, si dhe kujdesin profesional, që ofrohet nga familje të trajnuara e të licencuara kundrejt një shpërblimi financiar. Ai vendos kritere të qarta për familjet kujdestare, duke kërkuar kushte të përshtatshme banimi, integritet moral, shëndet të mire fizikë ose mendor, dhe pa histori penale dhe detyrimin për trajnime të posaçme.

Projektligji rregullon në detaje procedurat e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ: që nga identifikimi i nevojës, vlerësimi i situatës, marrja e mendimit të fëmijës, vendimi i komisionit shumëdisiplinar, e deri te miratimi nga gjykata. Procesi përfshin përgatitjen psiko-sociale të fëmijës, hartimin e planit individual të kujdesit dhe monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së tij në familjen kujdestare.

Një vend të rëndësishëm në ligj zënë të drejtat e palëve: fëmija ka të drejtë të rritet i mbrojtur, i përfshirë në vendimmarrje dhe të marrë mbështetje të gjithanshme; familja kujdestare ka detyrimin të ofrojë një mjedis të sigurt, të raportojë për ecurinë dhe të respektojë privatësinë e fëmijës; ndërsa familja biologjike ruan të drejtën për të qenë e informuar, për kontakte të mbështetura dhe për t'u përfshirë në programe riintegrimi, kur kjo është e mundur.

Ligji parashikon gjithashtu mekanizmat e financimit të shërbimit, të cilat mbulohen nga buxheti i shtetit, bashkitë dhe burime të tjera të ligjshme. Familjet profesionale përfitojnë pagë mujore për ofrimin e shërbimit dhe pagesën për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndërkohë që familjet kujdestare vullnetare mbështeten financiarisht për të përballuar shpenzimet e fëmijës, përfshirë ushqimin, higjienën, kujdesin dentar dhe shëndetësor, edukimin, veshjen, shëndetin, dhe të tjera sipas nevojës.

Një pjesë e veçantë e projektligjit i kushtohet kontrollit dhe inspektimit: parashikohen masa ndëshkuese për familjet kujdestare që shkelin detyrimet ose abuzojnë, si dhe për punonjësit që shpërdorojnë detyrën. Gjithashtu, vendosen mekanizma ankimi për çdo palë të përfshirë, përfshirë edhe vetë fëmijën, me komisione të posaçme pranë bashkive.

Në fund, projektligji ngarkon Këshillin e Ministrave dhe ministrin përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore dhe udhëzimeve që garantojnë zbatimin e tij të plotë. Ligji hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Projektligji është i përbërë nga 38 nene të organizuara në 8 Pjesë, si vijon:

Pjesa I, Dispozita të përgjithshme, përfshin nenet 1-7, si më poshtë:

- Neni 1, Objekti i ligjit, përcakton se ligji rregullon kujdesin alternativ në familje. Ai përshkruan format e shërbimit (kujdes vullnetar dhe kujdes profesional), subjektet që ofrojnë shërbimin, si dhe strukturat përgjegjëse publike dhe jo-publike përgjegjëse për zbatimin. Ky nen qartëson gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve, të familjeve kujdestare dhe të institucioneve që e zbatojnë ligjin.
- Neni 2, Qëllimi i ligjit është të garantojë që fëmijët pa kujdes prindëror të rriten në një mjedis familjar të sigurt dhe mbështetës. Ky ligj të mbrojë dhe të zhvillojë mirëqenien e fëmijës, duke u mbështetur gjithmonë në parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe duke parandaluar diskriminimin në çdo formë.
- 1. Neni 3, Fusha e zbatimit, përcakton se ligji zbatohet për çdo fëmijë pa kujdes prindëror, ose në rrezik për të humbur këtë kujdes, në nevojë për perkujdes dhe mbrojtje.

Kategoritë e fëmijëve që përfitojnë nga kujdesi alternativ në familje. Përfitues janë fëmijët e braktisur, fëmijët e prindërve të privuar nga liria, ata që gjenden në rrezik të dhunës, trafikimit ose shfrytëzimit, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e pashoqëruar dhe ata që ndodhen në emergjencë humanitare. Ky nen përjashton disa kategori, si p.sh. fëmijët që ndodhen nën masa penale me kufizim lirie ose ata që marrin përkujdesje shëndetësore afatshkurtër, kur prindërit ruajnë ende përgjegjësinë prindërore.

- Neni 4, Përkufizimet, jep kuptimet e termave kryesorë që përdoren në ligj. Për shembull, ai sqaron çfarë nënkuptohet me “familje kujdestare”, “kujdes alternativ profesional”, “kujdes nga të afërmit”, “monitorim”, “inspektim” dhe “plani individual i kujdesit”. Këto përkufizime sigurojnë një kuptim të qartë dhe të njëjtë për të gjithë aktorët që zbatojnë ligjin.
- Neni 5, Parimet, vendos parimet udhëheqëse të kujdesit alternativ. Ai thekson interesin më të lartë të fëmijës, parandalimin e ndarjes nga familja biologjike, përshtatshmërinë e kujdesit, pjesëmarrjen aktive të fëmijës në vendimmarrje, barazinë dhe mosdiskriminimin. Ai garanton ruajtjen e marrëdhënieve familjare dhe respektimin edhe të identitetit kulturor, fetar, gjuhësor të fëmijës.
- Neni 6, Bashkëpunimi ndërinstitutional, përcakton se institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile bashkëpunojnë për të hartuar dhe zbatuar planin individual të kujdesit, gjithmonë duke respektuar privatësinë dhe dinjitetin e fëmijës.
- Neni 7, Mbrojtja e të dhënave personale, parashikon që të dhënat personale të fëmijës dhe të familjes kujdestare trajtohen vetëm nga subjektet e autorizuar dhe vetëm për qëllime të ligjshme. Ai ndalon publikimin ose shpërndarjen e këtyre të dhënave dhe parashikon masa administrative ose penale në rast shkeljeje.

Pjesa II, Llojet, kriteret dhe procedura e shërbimit të kujdesit alternativ në familje, vijon me nenet 8-14, si më poshtë:

1. Neni 8, Llojet e kujdesit alternativ në familje, parashikon se kujdesi mund të jetë profesional ose vullnetar. Kujdesi profesional realizohet nga familje të trajnuara e të licencuara, ndërsa kujdesi vullnetar ofrohet nga familjet e të afërme ose familje pa lidhje familjare. Neni parashikon se rregullat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ, si dhe kushtet dhe procedurat për fillimin, ushtrimin dhe përfundimin e kujdesit alternativ sipas llojit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Neni 9, Kujdesi alternativ profesional, parashikon se ky shërbim ofrohet ofrohet si kujdestari e specializuar kundrejt shpërblimit financiar dhe nga familje të licencuara. Për raste të nevojës urgjente kujdesi alternativ profesional në familje ofrohet si kujdestari emergjence, ose si kujdestari e specializuar për grupe të caktuara fëmijësh.
- Neni 10, Kujdesi alternativ vullnetar, parashikon se ky kujdes ofrohet nga familjet e të afërme të fëmijës (si gjyshër, motra, vëllezër të rritur apo kushërinj) ose nga familje që nuk kanë lidhje gjaku por shfaqin vullnetin për të ofruar shërbim kujdestarie. Në raste të arsyetuara, kujdesi vullnetar alternativ nuk përjashtohet nga detyrimi për monitorim bazuar në vlerësimin e strukturave përgjegjëse sipas këtij projektligji.
- Neni 11, Masat parandaluese dhe ndërgjegjësuere, parashikon se bashkitë marrin masa të vazhdueshme për të forcuar prindërimin, për të parandaluar ndarjen e fëmijëve nga familjet e tyre biologjike, si dhe për të identifikuar në kohë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Bashkitë angazhohen gjithashtu të promovojnë ndërgjegjësimin e familjeve për t'u bërë kujdestare.
1. Neni 12, Kriteret dhe procedura e ofrimit të kujdesit alternativ në familje, parashikon se vetëm subjektet që plotësojnë kriteret të caktuara (moshë madhore, aftësi të plota ligjore, kushte banimi të përshtatshme jetese, shëndet i mirë, pa histori kriminale) mund të ofrojnë

kujdes. Procedura përfshin vlerësimin e thelluar të familjes, vendimmarrjen nga komisioni shumëdisiplinar dhe trajnimin e detyrueshëm. Neni parashikon se rregullat për kriteret dhe procedurën e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje, përfshirë shqyrtimin e kërkesës, regjistrimin, trajnimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ, si dhe rregullat e funksionimit të komisionit shumëdisiplinar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Neni 13, Licencimi i kujdesit alternativ profesional në familje, parashikon se familjet që përmbushin kriteret pajisen me licencë sipas legjislacionit për lejet dhe licencat. Rregullat e detajuara për licencimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Neni 14, Regjistri i kujdesit alternativ në familje, organizohet si pjesë e sistemit elektronik të shërbimeve sociale dhe në përputhje me standardet teknike të sigurisë dhe privatësisë, sipas legjislacionit në fuqi, që përfshin të dhëna për familjet kujdestare, fëmijët e vendosur, llojin dhe kohëzgjatjen e kujdesit, si dhe raportet e monitorimit. Bashkitë e përditësojnë regjistrin, ndërsa Shërbimi Social Shtetëror e administron në nivel kombëtar. Të dhënat trajtohen si konfidenciale dhe mbrohen nga ligji për të dhënat personale.

Pjesa III, Procedura e ofrimit të kujdesit alternativ në familje, vijon me nenet 15-28, si më poshtë:

1. Neni 15, Identifikimi, referimi dhe manaxhimi i rasteve në nevojë për vendosje në kujdes alternativ në familje, realizohet nga njësia/punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor. Ajo ndërmerr menjëherë masa dhe bashkëpunon me njësinë e mbrojtjes së fëmijës për të siguruar ofrimin e shërbimit. Vlerësimi dhe procedura për vendosjen në kujdes alternativ në familje, parashikon se njësia e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor menaxhon rastin dhe vlerëson nevojën e fëmijës për kujdes alternativ. Neni parashikon se procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Neni 16, Informimi dhe marrja e mendimit të fëmijës, parashikon se fëmija dhe familja biologjike/aktuale informohen për vendosjen në kujdes alternativ dhe fëmijës i merret mendimi për preferencat e tij. Intervista zhvillohet në kushte të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e fëmijës, në prani të psikologut. Mendimi dokumentohet verbal për fëmijët 6–10 vjeç dhe me shkrim për ata mbi 10 vjeç.
- Neni 17, Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje, parashikon se komisioni shumëdisiplinar i bashkisë shqyrton dosjen dhe merr vendim të arsyetuar për llojin dhe kohëzgjatjen e kujdesit. Vendimi përfshin masat paraprake për njohjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, mbështetjen për fëmijën dhe familjen kujdestare, si dhe përfshirjen e familjes biologjike kur është e mundur.
- Neni 18, Numri maksimal i fëmijëve në kujdes alternativ në familje dhe përjashtimet, parashikon se një familje mund të ketë deri në tre fëmijë në kujdes alternativ, duke përfshirë edhe fëmijët biologjikë ose të birësuar. Përjashtimisht, më shumë se tre fëmijë vendosen vetëm kur kjo është në interesin më të mirë të tyre, veçanërisht për të mos i ndarë vëllezërit e motrat.
- Neni 19, Shqyrtimi në gjykatë i kërkesës për vendosjen e fëmijës, parashikon se pas vendimit të komisionit, njësia e mbrojtjes së fëmijës paraqet kërkesën në gjykatë, duke bashkëlidhur dosjen e rastit. Gjykata shqyrton me përparësi çështjen dhe merr vendim brenda 10 ditëve. Vendimi i gjykatës i njoftohet menjëherë njësisë që ka ndjekur rastin.
- Neni 20, Procedura pas marrjes së vendimit në gjykatë, parashikon se njësia e mbrojtjes së fëmijës regjistron vendimin në regjistrin elektronik dhe njofton strukturat përkatëse. Ajo merr masa për regjistrimin e fëmijës në gjendjen civile të familjes kujdestare dhe për

përgatitjen paraprake të tij. Në raste emergjente, fëmija vendoset menjëherë në një familje që ofron kujdes profesional emergjent.

- Neni 21, Përgatitja e fëmijës për vendosje, parashikon se para vendosjes, masat paraprake për vendosjen e fëmijës në familjen e caktuar për kujdes alternativ përfshijnë hartimin e planit individual të kujdesit, fëmija përgatitet me mbështetje psiko-sociale, përshtatjen graduale të fëmijës për vendosje në familjen kujdestare me familjen kujdestare. Procesi përgatitor është i detyrueshëm dhe zhvillohet në bashkëpunim me psikologë e punonjës socialë, duke përfshirë edhe masa për kontaktet me familjen biologjike nëse rikthimi është i mundur.
- Neni 22, Standardet e ofrimit të shërbimit, parashikon se çdo fëmijë ka një plan individual të kujdesit, i cili rishikohet rregullisht. Familja kujdestare ofron kujdes sipas standardeve të miratuara dhe duhet të raportojë për çdo ndryshim të rrethanave. Nëse familja shpreh interes për birësim, procedura ndiqet sipas ligjit për birësimin.
- Neni 23, Vlerësimi periodik i situatës së fëmijës, parashikon se rasti i çdo fëmije vlerësohet periodikisht nga njësia e mbrojtjes së fëmijës në bashki me një ekip shumëdisiplinar. Vlerësimi përfshin gjendjen fizike, mendore, edukative dhe marrëdhëniet e fëmijës, dhe jep rekomandime për vijim ose ndryshim të kujdesit. Raporti u bëhet i ditur familjes kujdestare dhe institucioneve përgjegjëse.
- Neni 24, Raportimi për keqtrajtimin e fëmijëve, parashikon se çdo dyshim për abuzim, neglizhencë apo shkelje të të drejtave të fëmijës raportohet menjëherë tek njësia e mbrojtjes së fëmijës, policia ose linja e këshillimit për fëmijë. Raportimi mund të jetë edhe anonim. Në raste të konfirmuara, vendoset ndërprerja e kujdesit dhe rastet regjistrohen në regjistrin elektronik.
- Neni 25, Monitorimi i ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje, parashikon se kushtet e kujdesit monitorohen nga njësitë e mbrojtjes së fëmijës, me vizita periodike çdo dy javë në tre muajt e parë dhe më pas çdo muaj. Monitorimi përfshin vizita në vendbanim, intervista me fëmijën dhe familjen, vlerësim psikologjik, konsultim me shkollën dhe institucionet shëndetësore. Për çdo vizitë mbahet procesverbal i dokumentuar në dosjen e fëmijës. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, monitoron zbatimin e standardeve të shërbimit të kujdesit alternativ në familje në të gjithë territorin e vendit. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe Shërbimi Social Shtetëror sigurojnë zbatimin e rregullave të këtij ligji me qëllim harmonizimin e praktikave, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, dhe ofrojnë mbështetje teknike për strukturat përgjegjëse respektive lidhur me kujdesin alternativ.
- Neni 26, Inspektimi, parashikon se Inspektorati përgjegjës kontrollon respektimin e standardeve ligjore dhe profesionale. Inspektorët kanë detyrimin të referojnë menjëherë rastet e abuzimit ose neglizhencës. Rregullat e detajuara miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Neni 27, Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë, parashikon se OJF-të e licencuara ofrojnë mbështetje, trajnim dhe këshillim profesional për fëmijët dhe familjet kujdestare. Ato kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të bashkive dhe bëhen pjesë integrale e sistemit kombëtar të kujdesit alternativ. Rregullat për licencimin e tyre dhe bashkëpunimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pjesa IV, Të drejtat dhe detyrimet, vijon me nenet 28-30, si më poshtë:

- Neni 28, Të drejtat e fëmijës në kujdes alternativ në familje, parashikon se fëmija gëzon të gjitha të drejtat që burojnë nga legjislacioni vendas dhe ndërkombëtar, përfshirë mbrojtjen nga dhuna e shfrytëzimi, të drejtën për arsim, shëndet, mbështetje emocionale e sociale dhe pjesëmarrje në vendimmarrje sipas moshës e zhvillimit. Ai ka të drejtë të ruajë

privatësinë dhe dinjitetin, si dhe të mbajë lidhje me familjen biologjike, përveç rasteve kur kjo është në kundërshtim me interesin e tij.

- Neni 29, Detyrimet e familjes kujdestare, parashikon se familja kujdestare duhet të sigurojë një mjedis të sigurt dhe përfshirës, të respektojë të drejtat e fëmijës, të raportojë rregullisht për ecurinë e tij dhe të pranojë monitorimin e autoriteteve. Ajo është e detyruar të njoftojë për çdo ndryshim që ndikon në mirëqeninë e fëmijës. Familja mund ta shoqërojë fëmijën jashtë vendit vetëm duke informuar njësinë e mbrojtjes së fëmijës dhe autoritetet përkatëse.
- Neni 30, Të drejtat e familjes biologjike/të mëparshme, parashikon se familja biologjike ka të drejtë të informohet për vendosjen e fëmijës dhe të marrë informacione periodike për gjendjen e tij. Ajo mund të ruajë kontakte të sigurta me fëmijën, të përfshihet në programe prindërimi dhe në procesin e riintegrit të fëmijës, nëse kjo është në interesin më të lartë të tij. Marrëdhëniet mes familjes biologjike dhe asaj kujdestare rregullohen nga plani individual i kujdesit.

Pjesa V, Financimi i shërbimit të kujdesit alternativ në familje, vijon me nenet 31-32, si më poshtë:

- Neni 31, Parimet e financimit, parashikon se shërbimi financohet nga buxheti i shtetit, buxhetet vendore dhe burime të tjera të ligjshme. Financimi bazohet në llojin e kujdesit, kohëzgjatjen, nevojat e veçanta të fëmijës dhe numrin e fëmijëve të vendosur në të njëjtën familje.
- Neni 32, Mbështetja financiare për fëmijët dhe familjet kujdestare, parashikon se familjet që ofrojnë kujdes profesional marrin pagesa mujore dhe vjetore, si dhe regjistrohen në sigurime shoqërore e shëndetësore, si dhe familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ përfitojnë mbështetje financiare për të përballuar shpenzimet e kujdesit për fëmijën/t, Rregullat dhe masat e financimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pjesa VI, Masat dhe e drejta e ankimit, vijon me nenet 33-34, si më poshtë:

- Neni 33, Masat për familjet që ofrojnë kujdes alternativ, parashikon se familjet që shkelin detyrimet e ligjit i nënshtrohen masave që shkojnë nga paralajmërimi deri te heqja përfundimtare e statusit kujdestar. Në rast abuzimesh të rënda ose të përsëritura, ato humbasin përgjithmonë të drejtën për të ofruar kujdes. Vendimi merret nga komisioni shumëdisiplinar dhe është i ankimueshëm, ndërkohë që fëmija transferohet menjëherë në një familje tjetër profesionale emergjente.
- Neni 34, Masat për punonjësit përgjegjës për kujdesin alternativ në familje, parashikon se punonjësit që shkelin ligjin i nënshtrohen masave disiplinore sipas rregullave të shërbimit civil ose marrëdhënies së tyre të punës. Rastet e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës ose mosveprimit që dëmtojnë fëmijën i referohen organeve kompetente për ndjekje penale.

Pjesa VII, Mjetet ligjore mbrojtëse administrative, vijon me nenet 35-36, si më poshtë:

- Neni 35, E drejta e ankimit, parashikon se çdo subjekt i përfshirë në kujdesin alternativ ka të drejtë të ankimojë vendimet që lidhen me përzgjedhjen ose heqjen e statusit të familjes kujdestare, me ndërprerjen e kujdesit ose me masat ndaj saj. Fëmija ka të drejtë të paraqesë ankesa për procesin e vendosjes dhe trajtimin gjatë kujdesit, vetë ose përmes përfaqësuesve ligjorë e profesionistëve.
- Neni 36, Shqyrtimi i ankesave, parashikon se pranë çdo bashkie ngrihet një komision i posaçëm që shqyrton ankesat e regjistruara në Regjistrin elektronik brenda 15 ditëve.

Vendimi i komisionit është i arsyetuar, i qartë dhe merr parasysh moshën e fëmijës. Nëse afati nuk respektohet, ankuesi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Rregullat e funksionimit të komisionit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pjesa VIII, Dispozitat e fundit, vijon me nenet 37-38, si më poshtë:

- Neni 38, Aktet nënligjore, parashikon se Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, për të zbatuar dispozitat që kërkojnë rregullim të mëtejshëm. Ministri përgjegjës për çështjet sociale miraton udhëzimet për standardet e shërbimit.
- Neni 39, Hyrja në fuqi, parashikon se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII.INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHET PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për çështjet sociale për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

VIII.PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKAKTIT

Projektligji është hartuar në kuadër të punës së realizuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër Nr. 156, datë 28.03.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik të punës për hartimin e ndryshimeve të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ dhe hartimin e planit të procesit të transformimit të qendrave rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë 2025-2026”, me ekspertizë teknike ligjore, mbështetur nga UNICEF.

Gjatë periudhës për hartimin e projektligjit janë realizuar një sërë takimesh konsultuese me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucionet e pavaruara, për hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ më 05 Qershor dhe 19 Shtator 2025, takim me anëtarët e grupit teknik të punës më 18 prill, 30 maj (online) si dhe 18 Shtator 2025, si dhe takime të vijueshme për rishikimin e draftit. Po ashtu, draftligji është diskutuar paraprakisht me strukturat vendore (NJMF/NJVNR) (online 16 Shtator) dhe fizikisht më 18 Shtator 2025. Drafti i projektligjit është ripunuar sipas sugjerimeve të marra nga konsultimet paraprake.

Projektakti dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Llogaritja e efektit financiar bazohet në analizën e bërë për kostimin e projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”. Shpenzimet për zbatimin e këtij projektligji akordohen dhe përballohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, njësiti e vetëqeverisjes vendore dhe programet buxhetore përkatëse. Në këtë analizë u

vlerësuan shpenzimet vjetore për periudhën trevjeçare 2026-2028, në një format i cili orienton institucionet publike në planifikimin e buxhetit.

Efekti i përgjithshëm financiar shtesë i projektligjit është vlerësuar në 365 milionë lekë, i shpërndarë në tre vjet, dhe përbën 0,002 përqind të PBB-së në vitin 2026 (51.2 milionë lekë), deri në 0,005 përqind të PBB-së në vitet 2028 e më tej, kur efekti financiar i projektligjit do të materializohet plotësisht (157.5 milionë lekë në vitin 2028).

Më poshtë janë paraqitur shpenzimet vetëm për ato nene, zbatimi i të cilave është vlerësuar që sjell efekte në buxhetin e institucioneve:

1. Krijimi i regjistrit të përkujdesit alternativ në familje

Regjistri elektronik i të dhënave për përkujdesin alternativ në familje organizohet si pjesë e sistemit elektronik të shërbimeve sociale. Për krijimin e një moduli të posaçëm të përkujdesit alternativ në regjistrin elektronik të shërbimeve sociale është parashikuar një kosto prej 1 milionë lekësh gjatë vitit 2026, e cila do të përballohet nga programi i mbrojtjes sociale i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

2. Kompensimi financiar për kujdesin alternativ

Projektligji parashikon një paketë mbështetjeje financiare për familjet kujdestare, i cili ndryshon në varësi të llojit të familjes kujdestare, në përputhje me parashikimet e nenit 33 të këtij projektligji. Me qëllim tërheqjen dhe ruajtjen e një trupe të kualifikuar në kujdesin alternativ, personat që ofrojnë kujdes alternativ kanë të drejtën për një pagë mujore për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ profesional në familje (përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), përveç pagesës mujore dhe vjetore që familja merr për çdo fëmijë në kujdesin e tyre. Niveli i kompensimit financiar mujor për kujdestarët profesionalë është i barabartë me pagën minimale në fuqi, ndërsa për kujdestarët profesionalë që kanë në kujdestari fëmijë me aftësi të kufizuar është i barabartë me pagën mesatare për lloje të ngjashme kualifikimi, por më i ulët se paga mesatare e punonjësve socialë në sistemin publik. Shpenzimet e përgjithshme për paketën financiare për kujdestarët profesionalë arrijnë në 21,6 milionë lekë në vit për familjet kujdestare në vitin e parë (2026) të zbatimit të ligjit, kur parashikohet të angazhohen rreth një e dyta e numrit indikativ të përgjithshëm të familjeve kujdestare të specializuara, deri në 86 milionë lekë në vit nga viti i dytë (2027), kur parashikohet të arrihet kapaciteti maksimal. Në rast të rishikimit të nivelit të pagës minimale, ky efekt financiar rritet në përkatesisht 25,7 dhe 103 milionë lekë.

Niveli i pagesës mujore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ propozohet në nivelin 12,000 lekë për çdo fëmijë (përfshirë fëmijët në familje me lidhje gjaku, për të cilët pagesa aktuale është 9,000 lekë në muaj sipas VKM 129/2018 “për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”), përllogaritur në përputhje me rritjen e përpjesshme të shpenzimeve të familjes me rritjen e numrit të anëtarëve të saj, sipas anketës së matjes së nivelit të jetesës (Instat) dhe një pagesë vjetore për shpenzime veshmbathjeje, materiale shkollore e të tjera; të cilat propozohen të indeksohen çdo vit. Shpenzimet për këto zëra përllogariten në rreth 28,5 milionë lekë në vit për vitin e parë të zbatimit të ligjit dhe rriten deri në 71 milionë lekë në vit në vitin fundor të PBA-së (2028), për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve dhe indeksimit vjetor të pagesave (2% indikative).

Gjithashtu, këto parashikime përfshijnë edhe shpenzimet për rastet e vendosjes së fëmijëve në kujdes alternativ në situata emergjente sipas nenit 10.2 të projektligjit.

Këto shpenzime përballohen nga programi buxhetor i mbrojtjes sociale i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe janë të përfshira në tavanet buxhetore për periudhën 2026- 2028.

3. Vlerësimi dhe monitorimi i familjes kujdestare dhe ecurisë së fëmijës në kujdes alternativ

Vlerësimi dhe monitorimi i familjeve dhe fëmijëve në kujdes alternativ kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë secilës bashki në përputhje me parashikimet e këtij projektligji. Ky proces përfshihet në detyrat organike të këtyre strukturave dhe nuk kanë efekte financiare shtesë.

PROPOZUESI

Evis SALA

MINISTËR

Në mungesë dhe me urdhër

ZËVENDESMINISTËR

Denada SEFERI